



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P.731/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.10.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Don Jurge” & “Colombo” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-73855-06-07-2018 me objekt “*Mirembajtje Rutine me Performance Rruga Fier-Ballsh-Fratar + Rruga Ballsh – Aranitas + Rruga Metohasim – Kafaraj + Rruga K/Rruga Nacionale-Bylis 63.3 Km*”, me fond limit 31,703,725 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 10.07.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokaster.

**Ankimues:** BOE “Don Jurge” shpk & “Colombo” shpk  
Levan Fier

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokaster  
Ish Zona Industriale Gjirokaster

**Subjekt i Interesuar:** Shendelli shpk  
Lagjja "Kastrioti", Rruga "Andon Profka", 2 Kullat Fier.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:****I**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

**II****Rrethanat e çështjes**

II.1 Në datën 07.06.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-73855-06-07-2018 me objekt “Mirembajtje Rutine me Performance Rruga Fier-Ballsh-Fratar + Rruga Ballsh – Aranitas + Rruga Metohasim – Kafaraj + Rruga K/Rruga Nacionale-Bylis 63.3 Km”, me fond limit 31,703,725 leke pa TVSHB, zhvilluar në datë 10.07.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokaster.

II.2. Në datën 10.07.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 26.07.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- B93	pa ofertë	I skualifikuar
- Adem Pojani	pa ofertë	I skualifikuar
- Florida	pa ofertë	I skualifikuar
- Agbes Konstruksion	pa ofertë	I skualifikuar
- Ardmir	pa ofertë	I skualifikuar
- Don Jurge	20,134,188	I skualifikuar
- Caushi	20,868,600	I skualifikuar
- Sark	22,605,280	I skualifikuar
- Shendelli	23 508 800	I kualifikuar
- Beqiri	26 773 720	I skualifikuar
- B93II	26,794,280	I kualifikuar
- Senka	28,207,400	I skualifikuar

II.4. Në datën 26.07.2018 BOE “Don Jurge” shpk & “Colombo” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Bashkimi i Operatoreve ekonomik Don Jurge shpk & Colombo shpk, rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte: Operatori ekonomik Colombo shpk, pjese e ketij bashkimi, ne lidhje me deshmite per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, per kapacitetin teknik “Autobitumatriçe”, në pronësi ose me qira, cope 1, ka paraqitur kontraten e qerese me subjektin VARAKU E shpk, me afat perdorimi 24 muaj. Po ky mjet me targe DR 7405 E, i eshte dhene me qera dhe subjektit Caushi shpk, per te njejten periudhe kohore, ose qe perfshin kete periudhe, cfare e ben kete kontrate fictive dhe te pavlefshme.*
- *Vertetimet Nr. T00389646, Datë, 28.06.2018, (Për pagim Detyrimesh), paraqitur nga Operatori ekonomik Colombo shpk, Nr. T00389635, Datë, 28.06.2018, (Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin - E-SIG 02/a), Nr. T00408191, Datë, 06.07.2018, jane te pa nenshkruar rregullisht as me nenshkrim elektronik dhe as hard copy, ne kundershtim me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit.*
- *Operatori ekonomik Don Jurge shpk, pjese e ketij bashkimi, sipas kontrates se bashkepunimit ka marre persiper te kryej 56% te sherbimeve. Ne kundershtim me piken 2.3.12 te dokumenteve te tenderit ku percaktohet se ”Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik...cdo anëtar i grupit, duhet të dorëzojë dokumentat e kerkuara, ne perpjestim dhe perputhje me punet e marrra perisiper sipas marrevshjes se*

*bashkepunimit”, ky operator nuk disponon kategorine perkatese ne licencen profesionale NP – 12/A Punime të inxhinierisë së mjedisit.*

- *Per kapacitetin teknik “grejder” në pronësi / me qira, “asfaltoshtruese”, ne pronesi ose qera, operatori ekonomik Don Jurge shpk, ka paraqitur kontraten e qerese me subjektin “Spartaku shpk”, date 09.07.2018. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti “Beqiri shpk”, rezulton qe keto mjete i jane dhene me qera ketij te fundit sipas kontrates se qerese date 04.07.2018, konkurrent ne kete procedure, cfare verteton faktin qe kontratat jane fiktive dhe te pavlefshme. Per kapacitetin teknik “grejder” “Fabrike asfaltobetoni (QKL & Leje mjedisore) në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi”, operatori ekonomik Don Jurge shpk, ka paraqitur kontraten e furnizimit me subjektin “Spartaku shpk”, date 06.07.2018. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti “Beqiri shpk”, rezulton qe ky impjant i eshte dhene me qera ketij te fundit sipas kontrates se qerese date 04.07.2018, konkurrent ne kete procedure, cfare verteton faktin qe kontratat jane fiktive dhe te pavlefshme.*

II.5. Në datën 31.07.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit sqarojmë se: Kontrata e qerasë së lidhur midis shoqërisë Varaku E shpk dhe qerramarës Colombo shpk është një kontratë ligjore e parashikuar në dispozitat e kodit civil e nënshkruar para noterit dhe si e tillë ka efekte juridike. Fakti që është marrë me qera dhe nga një subjekt tjetër nuk përbën kusht për skualifikim pasi kontrata është berë me emër objekti, dmth shoqëria jonë do të marrë me qera dhe do të përdorë këtë mjet vetëm në këtë procedurë prokurimi nqs se ne do të shpallemi fitues. Pra në këtë procedurë prokurimi vetëm një subjekt do të shpallet fitues dhe vetëm ai subjekt do të përdorë këtë mjet. Në qoftë se ne nuk do të shpallemi fitues nuk do ta përdorim këtë mjet dhe e njëjta gjë për subjektin tjetër që ka një kontratë qeramarrje për këtë objekt me këtë mjet. Subjekti qeradhënës mund të lidhë kontrata qeraje me disa subjekte për një procedurë prokurimi por në fund vetëm subjekti që do të shpallet fitues do të përdorë këtë mjet. Referuar dhe vendimeve të mëparshme të KPP 157/2018 me objekt paraqitjen e mjeteve të njëjta për të njëjtën procedurë hedhim poshtë këtë arsye skualifikimi nga ana juaj duke e konsideruar plotësisht ligjore dhe konform kërkesave të DST.*
- *Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit ju sqarojmë se shoqëria Colombo shpk ka paraqitur në sistemin elektronik të prokurimeve për këtë procedurë vërtetime të shkarkuara online nga sistemi E-Albania , këto vërtetime janë plotësisht të rregullta , të shoqëruara me vulën elektronike dhe barkodin e vendosur në mënyrë elektronike nga DRT Fier. Këto dokumenta zyrtare të shkarkuara online janë bërë nga ana jonë bashkim në një folder gjatë të cilit kanë humbur vetëm një pjesë të parëndësishme për vlerësimin e origjinalitetit të tyre. Edhe nëse ju si AK do të kishit pasur dyshime mbi vërtetësinë dhe origjinalitetin e tyre patjetër duhet të kishit kërkuar apo bërë verifikimet e nevojshme në bazë të së drejtës që ju jep ligji*

*për ta bërë këtë. Këto dokumenta përvecse i disponojmë ashtu si i kemi shkarkuar online mund të verifikoni dhe në faqen elektronike E-Albania.*

- *Në lidhje me arsyen e tretë të skualifikimit ju sqarojmë se: BOE ka paraqitur dokumentacionin e plotë në përputhje me DST dhe LPP. Është paraqitur Licenca e dy shoqërive . Kategoria e Licencës NP 12 është plotësuar nga shoqëria Colombo shpk. Në bazë të LPP kategoria e licencave është e rëndësishme të plotësohet nga njëri prej OE. Sa më sipër kjo kërkesë është përmbushur nga ana jonë. Gjithashtu është i pabazuar skualifikimi juaj për sa kohë që ju kërkon kategorinë e licencës NP 12 dhe nuk keni kërkuar një inxhinier mjedisi i cili justifikon dhe kërkesën për NP 12. Një shoqëri e përfiton kategorinë e licencës së mjedisit duke pasur një kontratë pune me një inxhinier mjedisi. Ju nuk keni kërkuar një ing mjedisi dhe pavarësisht kësaj ne kemi plotësuar këtë kërkesë me paraqitjen e licencës së Colombo shpk.*
- *Në lidhje me arsyen e katërt të skualifikimit ju sqarojmë se: Kontrata e furnizimit e lidhur midis shoqërisë Don Jurge shpk dhe Spartaku shpk është një kontratë plotësisht ligjore e parashikuar në dispozitat e kodit civil e nënshkruar rregullisht para noterit. Shoqëria Spartaku shpk në kontratën e qerasë që ju përmendni nuk ka dhënë me qera fabrikën e asfaltobetonit por vetëm mjetet , në kontratë është shprehur qartë që për fabrikën e asfaltobetonit do të paguhet në bazë të sasisë së prodhuar dmth sasisë me të cilën do të furnizohet Beqiri shpk në bazë të së cilës do të lëshohet edhe fatura tatimore , kjo kontratë nuk pengon aspak palën qeradhënëse të furnizojë me materiale subjekte të tjera. Firma Spartaku ka të drejtë të furnizojë me materiale shoqërinë Don Jurge dhe nuk ka asnjë pengesë nëse dy subjekte furnizohen në të njëjtën pikë furnizimi. Pra ky nuk mund të jetë një kriter skualifikues për sa kohë që Theksojmë se furnizimi me materiale do të bëhet vetëm nëse ne do të shpallemi fitues. Ndërsa për sa i përket mjetit Grejder dhe asfaltoshtruese si sqaruam dhe më sipër mjeti do të përdoret vetëm nga OE Fitues dhe nuk përbën kusht skualifikues fakti që mjeti i është dhënë me qera një operatori tjetër ekonomik. Në konkurim do të ketë vetëm një fitues që do të thotë se në rast se do të jemi ne fitues atherë mjeti do të përdoret nga ne dhe po e njëta gjë do të ndoshë nëse fites do të jetë operatori tjetër qeramarrës i mjetit. Shoqëria jonë disponon kontratë qeramarrje në përputhje me ligjin të nënshkruar para noterit dhe nuk kemi të bëjmë aspak me një kontratë fiktive.*

*Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e shoqërisë sonë.*

II.6. Në datën 07.08.2018 me shkresën nr. 530 prot bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Don Jurge” shpk& “Colombo” shpk , është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 16.08.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. NËPËRMJET shkresës nr.584 datë 27.08.2018 protokolluar me tonën me nr.1405/2 datë 29.08.2018 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Don Jurge” sh.p.k & “Colombo” shpk mbi skualifikimin e ofertës së tyre, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyetimin se “*Operatori ekonomik Don Jurge shpk, pjese e ketij bashkimi, sipas kontrates se bashkepunimit ka marre persiper te kryej 56% te sherbimeve. Ne kundershtrim me piken 2.3.12 te dokumenteve te tenderit ku percaktohet se ”Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik...cdo anëtar i grupit, duhet të dorëzojë dokumentat e kerkuara, ne perpjestim dhe perputhje me punet e marrra perisiper sipas marrevshjes se bashkepunimit”, ky operator nuk disponon kategorie perkatese ne licencen profesionale NP – 12/A Punime të inxhinierisë së mjedisit*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Operatorët ekonomikë “Don Jurge” sh.p.k & “Colombo” sh.p.k kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të kontratës së bashkëpunimit lidhur para një noteri publik Nr.1960 Rep, Nr.854 Kol datë 09.07.2018. Nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit rezulton se bashkimi i përkohshëm i shoqërive është krijuar për realizimin e objektit “*Mirembajtje Rutine me Performance Rruga Fier-Ballsh-Fratar + Rruga Ballsh – Aranitas + Rruga Metohasim – Kafaraj + Rruga K/Rruga Nacionale-Bylis 63.3 Km*”

Referuar kontratës së mësipërme të bashkëpunimit parashikohet se [...]Pjesmarrja e kompanive në këtë bashkëpunim shoqërisht do të jetë sipas përqindjes së mëposhtme: Shoqëria Don Jurge shpk do të mbulojë 56 % të angazhimit të kontratës me autoritetin kontraktor. Shoqëria Colombo shpk do të mbulojë 44% të angazhimit të kontratës kryesore me autoritetin kontraktor. Ndarja e detajuar e punëve /shërbimeve do të jetë sipas preventivit bashkëngjitur kontratës së bashkëpunimit [...]

Referuar preventivit të ndarjes së punimeve ndërmjet anëtare të bashkimit të operatorëve rezulton se Colombo shpk do të realizojë zërat si më poshtë:

- Pastrim i kanaleve anësore të kullimit
- Pastrim i tombinove ekzistuese rrethore dhe katrore nga mbetjet sedimente apo bimët dhe prurjet e ngurta të depozituara.

- Nivelim i bankinave dhe mbushjeve ne nivelin fillestar
- Preerja, shkulja dhe pastrimi i bimësisë së rritur në zonën e rrugës
- Pastrimi i karazhatës nga aluvionet.
- F.V Guardrail N2 anësor me valëz E3 +aksesorët 50%
- Shtresë asfaltobetoni 4 cm me granil gurë kave memakeri (mesatar) në vlerën 552,695

Don Jurge shpk zërat si më poshtë:

- Sigurimi, shtrimi dhe ngjeshja e asfaltit me penetrim apo asfaltit të papërgatitur në gropat e përgatitura
- Sigurimi, shtrimi në gropa dhe ngjeshja e makadimit të lidhur me ujë të aprovuar për të krijuar shtresën bazë të rrugës
- Sigurimi, shtrimi në gropa dhe ngjeshja e zhavorit/granilit për të riparuar karaxhatën dhe bankinat
- Struktura monolite betoni C 16/20
- Riparime me mur guri me II.cim M25
- Gabiona me rrjt teli të zinguar, gur kave 1x2x2
- F.V Tabela të ndryshme rrugore D=60cm
- F.V Tabela rrugore treguese 150x40 cm
- Vijëzim rruge me bojë biokomponent spraj
- Përvijues anësor normal

III.1.2. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.3.6 “Kapaciteti teknik” rë dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

*2.3.6 Operatorët ekonomike duhet të disponojnë licensat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këto duhet të paraqesin licensën perkatese të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”. Shqyrtimi i licensave do të behet mbi bazën e rregullave të parashikuara në sa më sipër. Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategorite e mëposhtme:*

- NP – 1/A Punime germimi në toke.
- NP – 4/B Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- NP – 5/A Punime nentokesore, ura e vepra arti.
- NP – 12/A Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- NS – 6/A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
- NS – 7/A Bariera dhe mbrojtje rrugore

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjise, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008).*

III.1.3. Në shtojcën “modifikim mbi dokumentat e tenderit” të procedurës së prokurimit objekt ankimi bëhen modifikimet e kritereve si më poshtë:

**Ishte :**

*Në pikën 2.3.6 paragrafi fundit të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjise, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008).*

**Bëhet:**

*“Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë /kenë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë institucioneve përgjegjëse për dhënien e licencave profesionale në Republikën e Shqipërisë”.*

**Ishte:**

*Në pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “Kur mjetet / pajisjet teknike janë me qera, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qerave, dhe bashkëlidhur të gjithë dokumentet e përshkruar në paragrafët 1, 2 dhe 3, sipas perkatesise. Kontratat e qerave duhet të jenë të nënshkrura jo më parë janari viti 2018, të përfshijnë të gjithë periudhën e realizimit të kontratës dhe.....”*

**Bëhet:**

*“Kur mjetet / pajisjet teknike janë me qera, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qerave, dhe bashkëlidhur të gjithë dokumentet e përshkruar në paragrafët 1, 2 dhe 3, sipas perkatesise. Kontratat e qerave duhet të përfshijnë të gjithë periudhën e realizimit të kontratës dhe.....”*

III.1.4. Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se :

- “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....



- 2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.
- “3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.
- Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

III.1.5. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit

III.1.6. Referuar sa më sipër, Komisioni konstaton se në marrëveshjen e bashkëpunimit lidhur mes palëve, operatori ekonomik “Don Jurge” sh.p.k ka marrë përsipër realizimin e 56 % të detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë për realizimin e zërave të përcaktuar në preventivin e punimeve. Ndërsa operatori ekonomik “Colombo” shpk ka marrë përsiper realizimin e 44% detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë për realizimin e zërave të përcaktuar në preventivin e punimeve.

III.1.7. Referuar preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit objekt ankimi rezulton se janë parashikuar zëra punimesh si vijon: Pastrim i kanaleve anësore të

kullimi, Pastrim i tombinove ekzistuese rrethore dhe katrore nga mbetjet sedimente apo bimët dhe prurjet e ngurta të depozituara; Nivelim i bankinave dhe mbushjeve ne nivelin fillestar; Prerja, shkujla dhe pastrimi i bimësisë së rritur në zonën e rrugës; Pastrimi i karazhatës nga aluvionet, F.V Guardrail N2 anësor me valëz E3 +aksesorët , Shtresë asfaltbetoni 4 cm me granil gurë kave memakineri (mesatar) të cilat referuar ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues janë marrë përsipër të realizohen nga anëtari i këtij bashkimi Colombo shpk. Ndërsa zërat e tjerë të preventivit të tilla si Sigurimi, shtrimi dhe ngjeshja e asfaltit me penetrim apo asfaltit të papërgatitur në gropat e përgatitura, Sigurimi, shtrimi në gropa dhe ngjeshja e makadamit të lidhur me ujë të aprovuar për të krijuar shtresën bazë të rrugës, Sigurimi, shtrimi në gropa dhe ngjeshja e zhavorit/granilit për të riparuar karaxhatën dhe bankinat, Struktura monolite betoni C 16/20 , Riparime me mur guri me ll.cim M25, Gabiona me rrjt teli të zinguar, gur kave 1x2x2, F.V Tabela të ndryshme rrugore D=60cm, F.V Tabela rrugore treguese 150x40 cm, Vijëzim rruge me bojë biokomponent spraj, Përvijues anësor normal janë marrë përsipër të realizohen nga antari i bashkimit të operatorëve Don Jurge shpk.

III.1.8. KPP gjykon se ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të punëve për secilin anëtar të bashkimit nëpërmjet aktmarrëveshjes bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së kriteve në atë masë apo në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin e kontratës. Në rastin konkret KPP referuar formularit të ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë, konstaton se punimet të cilat konsiderohen punime të inxhinierisë së mjedisit dhe për të cilat duhet disponimi I licencës me kategorinë NP 12 janë marrë përsipër nga anëtari i këtij bashkimi Colombo shpk. Ndërsa anëtari tjetër i këtij bashkimi Don Jurge shpk nuk rezulton të ketë ka marrë përsipër realizimin e asnjë zëri punimi i cili të lidhet me punime të inxhinierisë së mjedisit e rrjedhimisht nuk ka arsye të plotësojë kapacitetin teknik lidhur me kategorinë e licencës NP 12.

III.1.9. Sa më sipër KPP gjykon se plotësimi i kapacitetit teknik lidhur me kategorinë e licencës NP 12 i takon operatorit ekonomik “Colombo” shpk në përputhje me përqindjen dhe kategorinë e zërave konkretë që ka marrë përsipër në realizimin e kësaj kontrate. Operatori ekonomik Don Jurge shpk nuk ka pasur detyrim për disponimin e kësaj kategorie licence sa kohë që zërat që ai do të realizojë nuk lidhen me punime të inxhinierisë së mjedisit.

Nisur nga arsyetimi i mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Don Jurge” sh.p.k dhe “Colombo” sh.p.k është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, dhe në përputhje me nenin 74 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar në përputhje me përqindjen dhe zërat konkretë që janë marrë përsipër të kryhen nga secili prej tyre.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Don Jurge” sh.p.k & “Colombo” shpk mbi skualifikimin e ofertës së tyre, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyetimin se “Vertetimet Nr. T00389646, Datë, 28.06.2018, (Për pagim Detyrimesh), paraqitur

nga Operatori ekonomik Colombo shpk, Nr. T00389635, Datë, 28.06.2018, (Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin - E-SIG 02/a), Nr. T00408191, Datë, 06.07.2018, janë të pa nënshkruar rregullisht as me nënshkrim elektronik dhe as hard copy, në kundërshtim me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

*Ofertuesi duhet të deklarojë se:*

- a) *Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.*
- b) *nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)*
- b) *nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,*
- c) *nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*
- d) *ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

*Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.*

*Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.*

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.*

***Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.***

***Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.***

***Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.***

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se anëtari i bashkimit të përkohëshëm të operatorëve ekonomikë në përmbushje të kritereve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjigjthme për kualifikim me përmbajtje si vijon: Unë i nënshkruari Diana Laba me cilesinë Administratorit të operatorit ekonomik “Colombo” Shpk deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
- Operatori ekonomik “Colombo” Shpk është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.
- Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik “Colombo” Shpk nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- Operatori ekonomik “Colombo” Shpk nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale,
- Operatori ekonomik “Colombo” Shpk nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv),
- Operatori ekonomik “Colombo” Shpk ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi
- Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.
- Data e dorëzimit të deklaratës 10.07.2018
- Vërtetim Nr.T00389646 datë 28.06.2018 “Për Pagim Detyrimesh i gjeneruar dhe vulosur nga sistemi elektronik (Drejtoria Rajonale Fier)
- Vërtetim Nr.T00389635 datë 28.06.2018 “Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore i gjeneruar dhe vulosur nga sistemi elektronik (Drejtoria Rajonale Fier)

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

III.2.4. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit

III.2.5. Kriteret për kualifikim vendosen pët të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës dhe rrjedhimisht ky i fundit do

të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se Autoriteti kontraktor në vlerësimin e ofertave nuk mund të përdorë asnjë kriter i cili nuk është i përfshirë në dokumentat e tenderit kjo në kuptim të nenit 55 “Kriteret e Përcaktimit të Ofertës Fituese” pika 2 e LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

III.2.6. Referuar sa më sipër KPP gjykon se plotësimi i kapacitetit lidhur me pagesën e të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi behet me një deklaratë sipas shtojcës 7 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në këtë kuptim KPP gjykon se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë edhe pse ka dorëzuar vërtetimet elektronike për pagimin e detyrimeve dhe ato të sigurimeve shoqërore e shëndetësore nuk ka qene në asnjë rast i detyruar ti dorëzonte ato pasi deklarata e paraqitur plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme për kualifikim përfshirë dhe atë për pagesën e detyrimeve. Autoriteti kontraktor në përputhje me shtojcën 7 në cdo kohë mund të bejë verifikimet e nevojshme lidhur me vertetësinë e informacionit që përmban deklarata e ofertuesve.

Akoma më tej vërtetimi Nr.T00389635 datë 28.06.2018 “Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore” jep një panoramë të qartë lidhur me numrin e punonjësve për periudhën e kërkuar në kriterin e vecantë të kualifikimit në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në këtë kuptim KPP gjykon se skualifikimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë me këtë arsyetim është i gabuar.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Don Jurge” sh.p.k & “Colombo” shpk mbi skualifikimin e ofertës së tyre, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyetimin se “*Bashkimi i Operatoreve ekonomik Don Jurge shpk & Colombo shpk, rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte: Operatori ekonomik Colombo shpk, pjese e ketij bashkimi, ne lidhje me deshmitë per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, per kapacitetin teknik “Autobitumatriçe”, në pronësi ose me qira, cope 1, ka paraqitur kontraten e qerese me subjektin VARAKU E shpk, me afat perdorimi 24 muaj. Po ky mjet me targe DR 7405 E, i eshte dhene me qera dhe subjektit Caushi shpk, per te njejten periudhe kohore, ose qe perfshin kete periudhe, cfare e ben kete kontrate fiktive dhe te pavlefshme” Per kapacitetin teknik “grejder” në pronësi / me qira, “asfaltoshtruese”, ne pronesi ose qera, operatori ekonomik Don Jurge shpk, ka paraqitur kontraten e qerese me subjektin “Spartaku shpk”, date 09.07.2018. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti “Beqiri shpk”, rezulton qe keto mjete i jane dhene me qera ketij te fundit sipas kontrates se qerese date 04.07.2018, konkurrent ne kete procedure, cfare verteton faktin qe kontratat jane fiktive dhe te pavlefshme. Per kapacitetin teknik “grejder”*

“Fabrike asfaltobetoni (QKL & Leje mjedisore) në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi”, operatori ekonomik Don Jurge shpk, ka paraqitur kontraten e furnizimit me subjektin “Spartaku shpk”, date 06.07.2018. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti “Beqiri shpk”, rezulton qe ky impjant i eshte dhene me qera ketij te fundit sipas kontrates se qerese date 04.07.2018, konkurrent ne kete procedure, cfare verteton faktin qe kontratat jane fiktive dhe te pavlefshme”, Komisioni i prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3.7 “kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcakohet kriteri si më poshtë :

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t’i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik.

Kerkohen te jene ne dispozicion keto mjete pune:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Rrul vibrues	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Autobitumatriçe	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Eskavatore fadrome	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Eskavator me Goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Kamioncine	në pronësi ose me qira	Copë 2
9	Fabrike asfaltobetoni (QKL & Leje mjedisore)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit lëshuar nga DPSHTRR (leje qarkullimi), çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit dhe fotot e tyre.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes / cdoganimi në RSH (ose kalimi me regjim të perkohshëm), fotot dhe fatura tatimore perkatëse.

- Për pajisjet teknike, kur janë në pronësi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes. Kur janë me qera duhet të paraqiten kontratat noteriale e qerese, faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes. Faturat që nuk janë sipas formatit të miratuar me tvsh (faturat e biznesit të vogël) duhet të shoqerohen me kuponin tatimor.

Kur mjetet / pajisjet teknike janë me qera, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qerese, dhe bashkëlidhur të gjithë dokumentet e përshkruar në paragrafët 1, 2 dhe 3, sipas perkatesise. Kontratat e qerese duhet të jenë të nënshkrura jo më parë janari viti 2018, të përfshijnë të gjithë periudhën e realizimit të kontratës dhe të deklarohet qartësisht nga qeradhensi që mjeti nuk i është dhënë me qera ndonjë subjekti tjetër për këtë periudhë.

Fabrika asfaltobetonit duhet të jetë e montuar në gjendje pune dhe e instaluar në një vendndodhje jo më larg se 60 km nga objekti (mjafton nga një pike e rrugëve që mirembahen nga Kontrata). Ajo duhet të jetë e pajisur me QKL dhe leje mjedisore. Ofertuesi duhet të deklarojë vendndodhjen e sakte të fabrikës së asfaltobetonit të montuar (nuk pranohet deklarate levizje impianti), të paraqesë planin e vendosjes të fabrikës së asfaltobetonit dhe të paraqesë fotografi të fabrikës së asfaltobetonit të montuar në vendndodhjen e deklaruar.

**Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".**

2.3.8 Makinerite e mesiperme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makinerite e mesiperme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

**Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".**

III.3.2. Në shtojcën "modifikim mbi dokumentat e tenderit" të procedurës së prokurimit objekt ankimi bëhen modifikimet e kritereve si më poshtë:

**Ishte :**

Në pikën 2.3.6 paragrafi fundit të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008).

**Bëhet:**

*“Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë /kenë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë institucioneve përgjegjëse për dhënien e licencave profesionale në Republikën e Shqipërisë”.*

**Ishte:**

*Në pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “Kur mjetet / pajisjet teknike janë me qera, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qerave, dhe bashkëlidhur të gjithë dokumentet e përshkruar në paragrafët 1, 2 dhe 3, sipas perkatesise. Kontratat e qerave duhet të jenë të nënshkrura jo më parë janari viti 2018, të përfshijnë të gjithë periudhën e realizimit të kontratës dhe.....”*

**Bëhet:**

*“Kur mjetet / pajisjet teknike janë me qera, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qerave, dhe bashkëlidhur të gjithë dokumentet e përshkruar në paragrafët 1, 2 dhe 3, sipas perkatesise. Kontratat e qerave duhet të përfshijnë të gjithë periudhën e realizimit të kontratës dhe.....”*

III.3.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Colombo” shpk në drejtim të përmbushjes së kriterit sa më sipër lidhur me disponueshmërinë e kapacitetit teknik “Autobitumatrice” ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Qeraje nr.1944 Rep nr.842 Kol datë 06.07.2018 lidhur ndërmjet Shoqëria Varaku shpk në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë Colombo shpk në cilësinë e qerramarësit me objekt mjetin Autobitumtrice i llojit ATV, Targa DR 7405E shoqëruar me certifikatë pronësie të mjetit, leje qarkullimi, taksa vjetore, certifikatë e kontrollit teknik, policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, Licencë nr.04 datë 22.08.2017 Për transport mallrash për të tretë me qera brenda vendit, certifikatë konformiteti, foto të mjetit. Në të parashikohet se kontrata e qerasë do të jetë për tenderin me objekt *Mirembajtje Rutine me Performance Rruga Fier-Ballsh-Fratar + Rruga Ballsh – Aranitas + Rruga Metohasim – Kafaraj + Rruga K/Rruga Nacionale-Bylis 63.3 Km*, për një periudhë kohore që fillon nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate deri në përfundimin e kontratës së lidhur me autoritetin kontraktor.
- Kontratë Furnizimi Nr.1431 Rep Nr.527 Kol datë 06.07.2018 lidhur ndërmjet shoqërisë Spartaku shpk dhe shoqërisë Don Jurge shpk me objekt Furnizim me asfaltobeton sipas kërkesave të porositesit. Në të parashikohet se: *Afati i kësaj kontrate është për tre vjet duke filluar ky afat nga sot dita e nënshkrimit të kësaj kontrate 06.07.2018 deri më 06.07.2021. Furnizuesi do të garantojë furnizimin e materialit duke ju referuar kërkesës që do të merret nga porositi. Kjo kontratë ka bashkëngjitur lejen mjedisore, certifikatë për vërtetim pronësie, hartë treguese, akt miratimi i lejes mjedisore, foto,*



- Kontratë Qeraje Mjeti Nr.1767 Rep, Nr. 1647 Kol datë 09.07.2018 lidhur ndërmjet shoqërisë Spartaku shpk dhe shoqërisë Don Jurge shpk me objekt ndër të tjera mjetet Asfaltshtruese dhe Autogreder. Në këtë kontratë parashikohet se: *koha e përdorimit të mjetit nga ana e qeramarrësit do të jetë për një afat 3 vjecar, afat i cili fillon nga data e nënshkrimit të kontratës 09.07.2018 dhe përfundon më datë 08.07.2021 me të drejtë rinovimi të kontratës. Gjatë kësaj periudhe të dhënies me qera të mjetit palët kontraktore nuk kanë të drejtë të prishin kontratën pa mbaruar afati i përcaktuar në këtë kontratë, afat i cili fillon me lidhjen e kontratës ose në rast të marrëveshjes ndërmjet palëve ata mund ta prishin këtë kontratë përpara përfundimit të afatit.*

III.3.4. Në nenin 46, të LPP-së parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

III.3.5. Në nenin 53, pika 3 të LPP-së parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*

III.3.6. Në nenin 28, pika 5, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) *licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose*
- c) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*
- ç) *dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.3.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

KPP gjykon se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Don Jurge” sh.p.k. & ”Colombo” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ka paraqitur

dokumentacionin përkatës në lidhje me makineritë dhe mjetet që duhen për realizimin e kontratës.

III.3.8. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, arsyeja e skualifikimit për bashkimin e operatorëve ekonomikë ankimues se qeradhënësi ka lidhur kontrata qeraje me subjekte të tjera për të njëtat mjete nuk tjetëron kontratat e lidhura mes subjekteve qeradhënëse dhe anëtarëve të bashkimit të përkohëshëm të shoqërive “Don Jurge” sh.p.k& “Colombo” shpk e aq më pak të shërbejë si shkak skualifikimi, pasi anëtarët e bashkimit të operatorëve dëshmojnë me dokumentacion konkret se disponojnë mjetet e kërkuara në kriterin e vecantë të kualifikimit me anë të kontratave të qerave të lidhura rregullisht para noterit. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor nuk mund të paragjykojë kontratat e qerave të paraqitura nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, përsa kohë që ato garantojnë vullnetin e lirë të palëve mbi disponimin e mjeteve.

III.3.9. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e punimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

III.3.10. BOE ankimues ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentacionin përkatës në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, duke e plotësuar kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

III.3.11. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik të vërtetohet se gëzon dhe disponon kapacitetet e duhura në lidhje me mjetet për realizimin me sukses të kontratës, fakt ky i vërtetuar nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur në përputhje me kriteret kualifikuese.

Sqarojmë se, për autoritetin kontraktor është e domosdoshme që një operator ekonomik pjesëmarrës të përmbushë kriteret e përcaktuara nga ai në dokumentat e tenderit duke vërtetuar se disponon kapacitetet ekonomike, financiare, teknike profesionale me dokumentacionin e paraqitur, dhe nuk duhet të jetë qëllim në vetvete skualifikimi i tij duke gjykuar dhe shqyrtuar këtë dokumentacion në mënyrë të njëanshme e sipërfaqësore.

Sa më sipër analizuar, konstatojmë se, jemi në kushtet kur nga ana e BOE ankimues është plotësuar kërkesa e përcaktuar në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor në lidhje me dokumentacionin për mjetet, pasi, në rastin konkret operatori ekonomik ankimues e disponon atë në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i BOE “Don Jurge” shpk & “Colombo” shpk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.

596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Don Jurge” sh.p.k. & “Colombo” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-73855-06-07-2018 me objekt “*Mirembajtje Rutine me Performance Rruga Fier-Ballsh-Fratar + Rruga Ballsh – Aranitas + Rruga Metohasim – Kafaraj + Rruga K/Rruga Nacionale-Bylis 63.3 Km*”, me fond limit 31,703,725 leke pa TVSHB, zhvilluar në datë 10.07.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokaster.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Don Jurge” sh.p.k. & “Colombo” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë bashkim operatorësh ekonomikë.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Don Jurge” sh.p.k. & “Colombo” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1405 Protokolli; Datë 16.08.2018**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**